

UNMIK/DIR/2000/2
22 Janar 2000

DIREKTIVA ADMINISTRATIVE NO.2000/2

**ZBATIMI I RREGULLORES SË UNMIK-ut NO.2000/3 TË 22 JANARIT 2000 MBI
TATIMET NË QARKULLIM NË KOSOVË**

Perfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm,

Në përputhje me autorizimin e dhënë atij konform me Rregulloren no.2000/XX të UNMIK-ut mbi tatimet në qarkullim në Kosovë,

Shpall direktivën administrative sa vijon:

Neni 1
Përjashtimet

1.1. Tatimet në qarkullim nuk do të vjelen nga sa vijon:

- (a) kategoritë e mallërave të shënuara në Aneksin A të kësaj direktive administrative;
- (b) mallërat e shitura për eksport, që i nënshtrohen dëshmisë së eksportit në pajtim me procedurat që do të lëshohen nga Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit Doganor të UNMIK-ut;
- (c) mallërat, për të cilat Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit Doganor të UNMIK-ut vendos se janë për t'u përdorur vetëm për qëllime humanitare dhe të cilat nuk do të ofrohen për shitje në Kosovë; dhe
- (d) mallërat e tjera të tilla, ashtu siç Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm do t'i specifikojë për përjashtim me anë të direktivës administrative, që u nënshtrohen kushteve të tilla ashtu si mendon ai ose ajo se iu përgjigjen.

1.2. Tatimet në qarkullim nuk do të paguhen nga sa vijon më poshtë:

- (a) misionet e huaja diplomatike dhe konsulare;

- (b) Kombet e Bashkuara, ose cilido organ i tyre duke përfshirë UNMIK-un, agjencitë e specializuara të Kombeve të Bashkuara, KFOR-i, organizatat ndërqeveritare ndërkombëtare dhe agjencitë qeveritare mbi mallërat e përdorura për qëllime zyrtare;
- (c) Kontraktorët e UNMIK-ut, agjencitë e specializuara të Kombeve të Bashkuara dhe KFOR-i, që importojnë mallëra për t'u përdorur vetëm nga ata kontraktorë, që janë të lidhur me përmbushjen e kontratave për UNMIK-un, agjencitë e specializuara të Kombeve të Bashkuara ose KFOR-i.
- (d) Organizatat joqeveritare të regjistruara me status të privilegjuar publik, siç është përkufizuar në rregulloren no.1999/22 të datës 15 nëntor 1999 të UNMIK-ut nëse mallërat përdoren nga organizata joqeveritare vetëm për përmbushjen e qëllimeve të interesit publik. Sidoqoftë, ky përjashtim nga tatimet në qarkullim nuk do të vlejë për alkoholin, etanolin, pijet alkoolike, verërat e pasuruara, verërat, birrën, pijet jo-alkoolike, kafënë, cigaretë, cigaretë puro, cigarillosin dhe prodhimet e tjera të përpunuara të duhanit; dhe
- (e) organizatat e tilla të tjera apo entitetet, ashtu siç do të specifikojë për përjashtim Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm me anë të direktivës administrative, që u nënshtrohen kushteve të tilla ashtu siç mendon ai ose ajo se iu përgjigjen.

Neni 2 Mbledhja

Si masë e përkohshme, tatimet në qarkullim do të vlerësohen, vjelen dhe mblidhen si vijon:

- (a) për mallërat e importuara: në vendkalimet e autorizuara kufitare ndërkombëtare dhe në depot e brendshme të doganimit; dhe
- (b) për mallërat e tjera që hyjnë në Kosovë ose mallërat e prodhuara në Kosovë; në zyrat për mbledhjen e taksave dhe vendet e prodhimit.

Neni 3 Procedurat dhe kundërvajtjet

Këto rregullore mbi pocedurat e tatimeve në qarkullim dhe kundërvajtjet do të mbeten të zbatueshme. Zyrtarëve, të cilët administrojnë këto çështje, do t'u dorëzohen udhëzimet.

Neni 4 Hyrja në fuqi

Kjo direktivë administrative do të hyjë në fuqi më -----Janar 2000 .

Bernard Kouchner
Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm

ANEKSI A
KATEGORITË E MALLËRAVE QË NUK I NËNSHTROHEN TATIMEVE NË
QARKULLIM

1. Prodhimet farmaceutike
2. Instrumentet mjekësore, kirurgjike dhe aparatura
3. Qumështi
4. Vaji dhe yndyrërat
5. Perimet
6. Pemët
7. Miell i grurit